

СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

Draft - raporti mbi aktivitetet e Këshillit për Etikë në Media në

Maqedoni

Janar – Dhjetor, 2016

СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

PËRMBAJTJA

1. HYRJE
2. SHYRTIMI I AKTIVITETEVE TË KËSHILLIT NË PËRIUDHËN JANAR - DHJETOR, 2016
 - 2.1 Aktivitete promovuese dhe informim i opinionit mbi Këshillin për Etikë në Media
 - 2.2 Aktivitete të rregullta të Komisionit për ankesa, procesi i ndërmjetësimit dhe vendimmarrjes
 - 2.3 Botime dhe hulumtime
 - 2.4 Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi me trupa, organizata dhe misione ndërkombëtare
 - 2.5 Komunikimi dhe aktivitete me mediat
 - 2.6 Aktivitete për planifikim strategjik
 - 2.7 Ndërtimi i kapaciteteve të KEMM-it
3. AKTIVITETE TË ARDHSHME TË KËSHILLIT PËR ETIKË NË MEDIA

1. HYRJE

Gjatë vitit të kaluar, Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni, aktivitetet e tij i përqendroi kryesisht në segmentet si në vijim:

- Aktivitete promovuese dhe informim të opinionit
- Aktivitete të rregullta të Komisionit për ankesa, procesi i ndërmjetësimit dhe vendimmarrjes
- Botime dhe hulumtime
- Bashkëpunim dhe rrjetëzim me organizata dhe misione ndërkombëtare e lokale
- Komunikim dhe aktivitete me mediat
- Aktivitete për planifikim strategjik
- Ndërtim të kapaciteteve të KEMM-it.

Këto janë donatorët që dhanë mbështetjen e tyre për funksionimin e KEMM-it dhe për realizimin e aktiviteteve gjatë vitit 2016: Ambasada e Mbretërisë Holandeze (përmes grantit dyvjeçar

СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

institucional, realizimi i të cilit u kompletua në dhjetor, si dhe në suaza të projektit MODEM „Monitorimi i demokracisë - 2015: pluralizmi politik në media, para dhe gjatë zgjedhjeve“ me Institutin për studime të komunikimit), më tej nga UNESCO Paris (përmes një granti veprimi njëvjeçar), nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim përmes Programit CIVICA (me grant institucional dyvjeçar), nga MIM-i përmes grantit të dhënë në suaza të projektit ReformMedia, i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Mbështetje është fituar edhe nga Misioni i OSBE-së në Shkup përmes realizimit të disa aktiviteteve të përbashkëta.

2. Shqyrtimi i aktiviteteve të Këshillit në periudhën janar – dhjetor, viti 2016

2.1 Aktivitete promovuese dhe informimi i opinionit mbi Këshillin për Etikë në Media

Janë zbatuar disa **debate me qytetarët** me qëllim të promovimit të misionit, procesit për dorëzimin e ankesave dhe të punës së Komisionit për Ankesa në Kavadarë, Gjevgjeli, Veles, Prilep dhe Gostivar.

Janë realizuar edhe **vizita në institucionet e arsimit të lartë**, gjegjësisht në fakultetin, Goce Dellçev në Shtip, në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, në Universitetin Ndërkombëtar Ballkanik dhe në Institutin për studime të komunikimit.

Janë prodhuar lloje të ndryshme të **materialeve promovuese dhe edukative**, siç janë buletinët, botimet për vetërregullimin dhe domethënien e tij, afishe, etj. Janë përpunuar video-materiale të shkurtëra për promovimin e KEMM-it dhe vetërregullimit, të cilat përmbajnë një përmbledhje të vendimeve të marra dhe bazave më të zakonshme për shkeljen e standardeve, vidoe-klipe për gjuhën e urrejtjes. KEMM-i ka marrë pjesë edhe në përgatitjen e filmit dokumentar të OSBE-së për lirinë e mediave.

KEMM-i inicoi një proces për **përgatitjen e Kartës për raportimin etik mbi zgjedhjet**, si rezultat i procesit konsultativ me të gjithë mediat, ndërsa u përcjell me një ceremoni të nëshkrimit të saj në Qendrën Informative të BE-së në Shkup, në shkurt të vitit të kaluar. Karta është nënshkruar nga 96 media në tërë vendin.

Janë përgatitur dhe realizuar **katër TV debate**, me temë „Etika në media dhe etika në shoqëri“ të emituara në Televizionin 24 në periudhën qershor - shtator 2016. Në këto debate është diskutuar mbi nevojën e vetërregullimit, reformat në sferën mediatike, shkeljet më të shpesha të standardeve

СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

profesionale në gazetari, gjuhën e urrejtjes në media, nevojën për bashkëpunim me sektorin civil, etj. TV debatet janë vendosur edhe në faqen e Fejsbukut të KEMM-it.

2.2 Aktivitete të rregullta të Komisionit për ankesa, proceci i ndërmjetësimit dhe i vendimmarrjes

Komisioni mbledhet së paku dy-tri herë në muaj, ndërsa sipas nevojës edhe më shpesh, në varësi nga vëllimi i ankesave të pranuar. Deri më tani janë pranuar rreth 180 ankesa. Anëtarë të Komisionit për ankesa, muajve të fundit punuan në përgatitjen e një botimi, i cili sublimon punën e këtij trupi, dhe së shpejti ky botim do të promovohet.

Anëtarët e Komisionit për ankesa marrin mbështetje për punën e tyre edhe nëpërmjet **komunikimit të rregullt me kolegët nga këshillat për etikë në rajon dhe nga Aleanca për Këshilla të pavarur për etikë në Evropë.**

2.3 Botime dhe hulumtime

Gjatë muajit korrik është shtypur botimi i OSBE-së „**Udhëzues për vetërregullim në media – të gjitha pyetjet dhe përgjigjet**“, ndërsa është përgatitur edhe një shtojcë e Udhëzuesit „Vetërregullimi dhe gazetaria maqedonase“. Është prodhuar edhe një **Udhëzues për parimet themelore profesionale në profesionin e gazetarisë**, autor i të cilit është doktor Dejan Donev.

Gjatë muajit prill– maj, është bërë një hulumtim mbi rolin e KEMM-it në forcimin e profesionalizmit të mediave dhe afirmimin e vetërregullimit. Në këtë hulumtim morën pjesë gazetarë dhe organizata civile në tërë vendin, ndërsa rezultatet u prezantuan në korrik. Hulumtimi u realizua me mbështetje nga projekti „Përforcimi i besueshmërisë në media në Evropën Juglindore dhe Turqi“, i financuar nga UNESCO dhe BE-ja.

Në fund të vitit të kaluar dhe në fillim të këtij viti janë bërë përgatitje për një analizë krahasuese mbi praktikën e këshillave për etikë në Evropë, si dhe të kornizës etike në Evropë. Rezultatet nga analiza e bërë do të prezantohen në një konferencë gjatë muajit prill.

СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

2.4 Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi me trupat, organizatat dhe misionet ndërkombëtare

KEMM-i është anëtare e Aleancës për këshilla të pavarur për etikë në media në Evropë (**Alliance of Independent Press Councils of EUROPE-AIPCE**, <http://www.aipce.net/>). Ndërkaq, Zyra Ekzekutive është në komunikim të rregullt me përfaqësuesit e anëtarëve të tjerë të Aleancës. Kjo në mënyrë të konsiderueshme ndihmon punën e Zyrës, me qëllim të shkëmbimit të informatave, njohurive, këshillave për zgjidhjen e rasteve të caktuara, etj. Përfaqësues të Këshillit për etikë në media morën pjesë në Kuvendin vjetor të kësaj Aleance që u mbajt në nëntor, në Stokholm, si dhe në konferencën ndërkombëtare me rastin e shënimit të ditës botërore të lirisë së mediave në maj, në Helsinki, ku u prezantua veprimtaria e KEMM-it. Përfaqësues të KEMM-it morën pjesë në një konferencë të rrjetit rajonal të trupave vetërregullues, në korrik, në Tblisi, Gjeorgji.

KEMM-i, në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Skup, ishte nikoqir i konferencës rajonale „Sfidat për këshillat për etikë në rajonin e Ballkanit“, në maj të vitit të kaluar, ku morën pjesë përfaqësues të trupave për vetërregullim në Shqipëri, Bosnje e Hercegovinë, Bullgari, Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi. Përfaqësuesit e KEMM-it e prezantuan veprimtarinë e deritanishme të Këshillit, Kodeksin e gazetarëve dhe marrëdhëniet midis qytetarëve dhe mediave me fokus në procesin e ndërmjetësimit. Qëllimi i konferencës ishte avancimi i bashkëpunimit rajonal dhe shkëmbimi i përvojave nga sfera e etikës në media.

KEMM-i ka mbështetur edhe formimin e Këshillit për etikë në media në Shqipëri, ndërsa planifikohen edhe aktivitete të ardhshme me këtë trup për vetërregullim.

2.5 Komunikimi dhe aktivite me mediat

KEMM-i vazhdoi me organizimin e ngjarjeve/aktiviteteve të rregullta për të njoftuar opinionin me punën e tij dhe me procesin e funksionimit të vetërregullimit. Janë organizuar shumë konferenca për shtyp, në të cilat reagohej për shkeljet e standardeve dhe raportimet joetike të mediave, ndërsa dërgoheshin edhe njoftime deri tek mediat, ka pasur pjesëmarrje të rregullt nëpër media, etj.

Në tetor u organizua punëtori me kryeredaktorë, pronarë të mediave dhe drejtorë të programeve informative. U diskutua mbi zhvillimin e ardhshëm të KEMM-it, si dhe për nevojën për mbështetje të vetërregullimit. Në të morën pjesë edhe përfaqësues të Këshillit për etikë në Norvegji, si dhe të Këshillit boshnjak për etikë.

СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

Një përfaqësues i KEMM-it mori pjesë në grupin punues për përgatitjen e parimeve Etike dhe profesionale të RTVM-së për raportimin mediatik mbi procesin zgjedhjet, proces ky që e inicioi ambasada e britaneze dhe MIM-i, bazuar në përvojën e BI-BI-SI-së.

2.6 Aktivitetet për planifikimin strategjik

Në prill ishte organizuar punëtori për zhvillim strategjik me anëtarët e Bordit Drejtues, Komisionit për ankesa dhe Bordit Mbikqyrës të KEMM-it. Janë analizuar plani strategjik, të gjitha dokumentet e KEMM-it në përputhje me sfidat, me të cilat ballafaqohemi në punën tonë. Si rezultat i këtij procesi, janë bërë propozime për ndryshimin e dokumenteve, ndërsa është definuar edhe baza për përgatitjen e një plani të ri strategjik të KEMM-it.

2.7 Ndërtimi i kapaciteteve të KEMM-it

Përfaqësues të Komisionit për ankesa dhe të Bordit Drejtues morën pjesë në trajnimin për këshillat për etikë në Evropën Juglindore dhe Turqi, në qershor, në Konjic, Bosnje e Hercegovinë. Në fokus të trajnimit ishin përvojat ligjore dhe etike si dhe sfidat në gazetari dhe raportimi mbi interesin publik në epokën digjitale.

2 Aktivitete të ardhshme të Këshillit për etikë në media

Aktivitetet e KEMM-it në periudhën e ardhshme edhe më tej do të jenë të përqendruara në informimin e vazhdueshëm të opinionit në lidhje me kompetencat e këtij trupi.

Në bashkëpunim me komunitetin e gazetarëve dhe mediave, do të punohet edhe në avancimin e kornizës etike, e në veçanti në pjesën e raportimit të mediave onlajn, dhe zbatimin efektiv të saj gjatë raportimit të mediave.

Janë planifikuar edhe aktivitete për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të anëtarëve të KEMM-it, bashkëpunim me mediat në edukimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me aplikimin e etikës në raportim, publikim të hulumtimeve, organizim të takimeve koordinative me donatorët, etj.

СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

Për shkak të nevojës për të krijuar mekanizma përkatës të vetë-qëndrueshmërisë së organizatës, janë planifikuar aktivitete për organizimin e ngjarjeve, si në partneritet me mediat dhe organizatat lokale, ashtu edhe me ekspertë ndërkombëtar.

KEMM-i planifikon pjesëmarrje aktive edhe në ndërmarrjen e aktiviteteve për rritjen e nivelit të arsimimit medial mes qytetarëve, me qëllim që të përmirësohet të kuptuarit e rolit të mediave dhe kontributi në përmirësimin e punës gazetareske. Në këtë drejtim, KEMM-i mori pjesë në Rrjetin e arsimimit medial të cilin e inicioi Agjencia për shërbime audio dhe audiovizuale.

Janë planifikuar edhe ngjarje të ardhshme me këshillat rjonal për etikë, si dhe me këshilla të rrjetit të AIPCE.